



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 89 prot.
2024

Tiranë, më 15. 01.

V E N D I M

Nr. 17, datë 15. 01. 2024

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”², të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 232 Regj., datë 26.10.2023, që i përket ankuesit T. B., kundër Bashkisë Lushnje, me pretendimin diskriminimin për shkak orientimit seksual³, gjendjes ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar⁴.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

T. B. ka parashtruar ndër të tjera në ankesë se: “... jam anëtar i komunitetit LGBTI, banues në qytetin e Lushnjes. Jam rritur jetim nga prindërit biologjik dhe kam qenë i birësuar. Tani jetoj i vetëm në kushte mbijetese të mjerueshme, ku ushqimin e siguroj duke lypur në rrugë. I kam kërkuar disa herë Bashkisë Lushnje në mënyrë verbale dhe me kërkesë shkresore (por nuk e disponoj) të më ndihmoj në rinovimin e banesës pasi jam dhe person PAK dhe me ato të ardhura që përfitoj nga kempit nuk më dalin për mjekim jo për të bërë një jetë dinjitoze. Bashkia më është përgjigjur se nuk ka fonde dhe duhet të presim për donator. Shefi i Emergjencave Civile së bashku me Kryetarin e Rajonit kanë ardhur e kanë bërë foto të banesës, por ende nuk është gjetur asnjë zgjidhje për mua.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

³ Referuar Vërtetimit të lëshuar nga Qendra “Aleanca kundër Diskriminimit LGBT”, më datë 20.06.2019, ankuesi është anëtarë i komunitetit LGBT në Shqipëri.

⁴ Referuar Vërtetimit të lëshuar nga Bashkia Lushnje, ankuesi rezultoi se ankuesi trajtohet me pagesë të aftësisë së kufizuar.

Ndihem i pambrojtur nga shteti im si nga ana fizike, psikologjike dhe ekomomike. Bullizohem dhe dhunohem sistematikisht. Unë kërkoj ndërhyrjen e Komisionerit për të vënë në lëvizje Bashkinë Lushnje që dhe unë të kem një strehë të përshtatshme për një qenie njerëzore dhe mos të trajtohem i diferencuar dhe me përbuzje për shkak të orientimit tim seksual. Trajtohem pa prioritet se jam i komunitetit LGBTI, nuk kam të ardhura, jetoj në gjendje të mjerueshme dhe i varfri “shkelet” më keq...”.

Në vijim, T. B., kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, si dhe t’i rregullohet banesa e tij nga ana e Bashkisë Lushnje.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, shkronja “a”, të LMD, ku parashikohet: “1. Komisioneri ka kompetencë: a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”;

Bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 1191/1 prot., datë 31.10.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, neni 32, pika 2, ka kërkuar nga ana e Bashkisë Lushnje, që të jepen parashtrime lidhur me të gjitha pretendimet e ngritura, nga subjekti ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Bashkia Lushnje, me shkresën⁵ Nr. 9049/1 prot., datë 06.11.2023, vuri në dispozicion të Komisionerit parashtrimet sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues, duke theksuar ndër të tjera se: “...T. B., banues në lagjen “Loni Dhamo”, të Njesisë Administrative Nr. 3, ju informojmë se nga Shërbimi Social, përfiton: Ndihmë Ekonomike (Buxhet Vendor) me masë 2000 lekë në muaj. Në bazë të vendimit të komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar përfiton pagesën prej 9729 lekë në muaj. Nga ana e Njesisë Administrative Nr. 3, T. B. është ndihmuar gjithnjë me pako ushqimore dhe do të vazhdojë të jetë në mbikëqyrjen e Punonjësës Sociale të Njesisë Administrative Nr. 3. Në lidhje me kërkesën tuaj, jemi në dijeni për rastin i cili disa herë është paraqitur në zyrën e Drejtorisë së Shërbimit Social, Sektori i Strehimit Social, është informuar se sipas ligjit 22/2018 “Për Strehimin Social”, duhet të dorëzojë dokumentacionin sipas VKM-së nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se T. B., nuk mund të jetë përfutur i programit të strehimit social, sipas ligjit 22/2018, nenit 4, për përmirësimin e kushteve të banesës ekzistuese....

Bashkia Lushnje për vitin 2023, nuk ka miratuar në fondin e saj buxhet për rikonstruksionin e banesave”.

2. Me anë të shkresës nr. 1191/3 prot., datë 14.12.2023, Komisioneri ju drejtua sërish Bashkisë Lushnje, duke kërkuar ndër të tjera: “Informacion dhe dokumentacion provues, nëse Bashkia Lushnje ka zhvilluar në 5 (pesë) vitet e fundit programe për rikonstruksionin e banesave në territorin e saj. Nëse po, në cilat zona në territorin e Bashkisë Lushnje? A është prekur zona ku banon T. B. nga këto programe për rikonstruksionin e banesave? Nëse po, përse nuk i është nënshtruar banesa e T. B. rikonstruksionit të saj?”

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Bashkia Lushnje, me shkresën⁶ Nr. 10306/1 prot., datë 21.12.2023, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...T. B. i është dhënë shërbim i vazhdueshëm nga Bashkia Lushnje dhe i është kthyer përgjigje nga Drejtoria e Shërbimit Social dhe nga Drejtoria e Shërbimeve Publike për këto kërkesa që keni parashtruar.”

Bashkëngjitur shkresës së sipërcituar, Bashkia Lushnje vuri në dispozicion kopje të shkresës kthim përgjigje drejtuar T. B., ku ndër të tjera e sqaron se: “...Bashkia Lushnje nuk parashikon në buxhetin e saj, investime në objekte të cilat janë pronë private. Sektori i Emergjencave Civile pranë Bashkisë Lushnje, mbështetur në VKM Nr. 329, datë 16.05.2012, merr në shqyrtim vetëm rastet e

⁵ Protokolluar pranë Komisionerit me shkresën Nr. 1191/2 prot., datë 08.11.2023.

⁶ Protokolluar pranë Komisionerit me shkresën Nr. 1191/4 prot., datë 28.12.2023.

fatkeqësive natyrore si zjarret, përmbytjet etj. Dhe jo banesat e amortizuara ndër vite. Në rastin tuaj nuk kemi të bëjmë me asnjë nga këto fenomene dhe për këtë arsye nuk kemi asnjë hapësirë ligjore për ndihmë. Propozojmë që ju, për problemin që keni të trajtoheni me bonus qiraje nga Bashkia Lushnje”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, T. B., i përket kategorisë së personave me aftësi të kufizuara, anëtarë i komunitetit LGBT dhe trajtohet nga ana e Bashkisë Lushnje me ndihmë ekonomike. Ankuesi thekson se jeton në një banesë e cila është e amortizuar në lagjen “Loni Dhamo”, të Njësisë Administrative Nr. 3, të Bashkisë Lushnje. Për këtë arsye, më datë 13.04.2023, i është drejtuar me anë të një kërkesë me shkrim Bashkisë Lushnje, duke kërkuar ndihmë për ndërtimin ose rikonstruksionin e banesës së tij.

Sa më sipër, rezulton se Bashkia Lushnje, përmes shkresës nr. 3157/1 prot., datë 26.04.2023, i ka kthyer përgjigje ankuesit se nuk ka hapësirë ligjore për ti ofruar ndihmë për ndërtimin ose rikonstruksionin e banesës së tij.

Në bazë të nenit 3, pika 1 të LMD, diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. Një nga format e diskriminimit parashikuar nga LMD, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3, pika 2, të këtij ligji si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të LMD.

Në Kreun IV, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD në nenin 20/1/a dhe b⁷, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi apo grupi personash në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

⁷ Neni 20/1/a dhe b, të ligjit nr. 10221/2010: “Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi...”

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ai i është nënshtruar ndonjë trajtimi të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për të përfituar të mira apo shërbime dhe më konkretisht në lidhje me ndërtimin ose rikonstruksionin e banesës së tij nga ana e Bashkisë Lushnje.

Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, në Kreun VII, parashikon “Funksionet dhe Kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Ndër të tjera në Nenin 21, të ligjit Nr. 139/2015, përcaktohen llojet e funksioneve të njësive të vetëqeverisjes vendore, duke parashikuar se:

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksione, kompetenca, si dhe funksione të deleguara.

2. Funksionet u njihen njësive të vetëqeverisjes vendore me këtë ligj. Funksione apo kompetenca të tjera mund t'u njihen një, disa apo të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore vetëm në bazë të ligjit.

3. Funksionet e deleguara u transferohen njësive të vetëqeverisjes vendore me ligj ose me marrëveshje. Në çdo rast delegimi i funksioneve shoqërohet nga transferta e mjaftueshme e qeverisjes qendrore për të financuar koston e ushtrimit të këtyre funksioneve”.

Neni 23 i tij, përcakton funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, duke parashikuar se: “Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:

- 1. Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.*
- 2. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.*
- 3. Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara.*
- 4. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.*
- 5. Ndriçimin e mjediseve publike.*
- 6. Transportin publik vendor.*
- 7. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit.*
- 8. Shërbimin e dekorit publik.*
- 9. Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.*
- 10. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.*
- 11. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.*

12. Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.

13. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

14. Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”.

Ndërsa në nenin 24 të tij, ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ku përcaktohen funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale, parashikohet se: “*Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:*

1. *Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.*

2. *Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.*

3. *Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.*

4. *Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”.*

Ligji Nr. 22/2018, “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, në nenin 11 “Llojet e programeve sociale të strehimit”, parashikon se:

1. *Në programet sociale të strehimit përfshihen:*

a) *programi i banesave sociale me qira, në vijim BSQ;*

b) *programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri dhe zonave të papërshtatshme;*

c) *programi i banesave me kosto të ulët, në vijim BKU;*

ç) *programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi;*

d) *programi për krijimin e banesave të përkohshme;*

dh) *programi i banesave të specializuara.*

2. *Njësitë e vetëqeverisjes vendore kujdesen që familjet dhe individët, të cilët nuk kualifikohen si përfitues në njërin program, të kenë mundësi për të kaluar dhe përfituar në një program tjetër strehimi social, kur plotësojnë kushtet ligjore.*

3. *Individi/familja nuk mund të përfitojë njëkohësisht nga më shumë se një program strehimi social në të njëjtën kohë.*

Neni 13, i ligjit Nr. 22/2018, përcakton “Kushtet për fitimin e statusit të përfituesit nga programet sociale të strehimit”, duke parashikuar se:

1. Statusin e përfituesit nga programet sociale, sipas këtij ligji, e gëzon çdo individ që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilët në momentin e aplikimit plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) nuk kanë në pronësi një banesë ose zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit apo banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi, për të cilat normat e strehimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) kanë mbetur të pastrehë, si rezultat:

i) i fatkeqësive natyrore;

ii) i prishjes së objekteve të pakualifikuara si banesë;

iii) i zhvendosjeve për shkak të investimeve publike dhe nga objektet e përjashtuara nga procesi i legalizimeve;

iv) nga zbatimi i akteve administrative dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë;

c) familjet që kanë një banesë të vjetër, në rrezik shembjeje, ose një banesë që i nënshtrohet një plani rregullues, për shkak të vjetërsisë së saj.

2. Përfitojnë nga programet e strehimit social të këtij ligji edhe shtetas të huaj, me qëndrim të rregullt në Shqipëri dhe që kanë përfituar nga organet kompetente statusin si “punëtor emigrant” dhe/ose “azilkërkues”.

3. Parashikimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohen vetëm për ato individë/familje që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të nenit 3 të këtij ligji.

4. Të drejtën për të përfituar nga programi i banesave sociale të specializuara e kanë edhe të miturit nën moshën 18 vjeç, pas liritimit ose përfundimit të programit të masës alternative të shmangies, në rastin kur bazuar në një vendim gjyqësor ose një akt administrativ, mbeten të pastrehë, për arsye se nuk duhet të jetojnë me prindërit, kujdestarin ligjor ose me familjen e tyre”.

Neni 15, përcakton “Rregulla të përzgjedhjes përmes sistemit të pikëzimit”, duke parashikuar se:

“1. Përveç rasteve të përmendura në pikën 1 të nenit 47/1 dhe nenit 64/2, përfshirja në programet sociale të strehimit bëhet nëpërmjet aplikimit në zyrën përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore të vendbanimit/vendqëndrimit të aplikantit.

1/1. Sistemi i pikëzimit në total duhet të përmbajë 100 pikë, ku çdo kriter i përcaktuar në nenin 16 përmban 25 pikë. Mënyra e shpërndarjes së pikëve, në përputhje me kriteret e përcaktuara, miratohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, i cili shpallet publikisht sipas ligjit për vetëqeverisjen vendore.

2. Në përzgjedhjen e subjekteve përfituese me anë të sistemit të pikëzimit përfshihen individë/familje, të cilët përmbushin nivelin e të ardhurave të parashikuara sipas çdo programi.

3. Shfuqizuar.

4. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore duhet të sigurojë listat e kërkuesve brenda një afati dymujor, nga data e njoftimit nga ana e subjektit publik ose privat që ofron dhe realizon një nga programet sociale të strehimit, kur ky subjekt nuk është vetë njësia e vetëqeverisjes vendore.

Marrëdhënia e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe subjektit që financon projektin përcaktohet me marrëveshje të posaçme.

5. Lista e përfituesve hartohet nga zyra përgjegjëse ose struktura e ngarkuar nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Lista e kërkuessve dhe dokumentacioni përkatës vlerësohen nga komisioni i strehimit dhe miratohen nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Pas marrjes së fondit takues nga buxheti i shtetit, këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton listën përfundimtare të përfituesve, të cilën e shpall publikisht sipas ligjit për vetëqeverisjen vendore në fuqi.

6. Familjet e listës kërkuese, që nuk arrijnë të përfitojnë strehim, qëndrojnë në listë pritjeje për t'u trajtuar:

a) me një program tjetër, kur ato nuk mund të përballojnë kostot e programit për të cilin janë miratuar;

b) në vitin pasues, kur fondet janë të pamjaftueshme”.

Neni 16, përcakton “Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve”, duke parashikuar se:

“Njësia e vetëqeverisjes vendore, në përzgjedhjen e individëve/familjeve përfituese, për hartimin dhe miratimin e sistemit të pikëzimit bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) Kushtet e strehimit, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi familjet që:

i) nuk disponojnë banesë në pronësi;

ii) banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje;

iii) banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;

iv) kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore;

v) familjet ose individët që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor;

vi) banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike.

b) Kushtet familjare, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi:

i) familjet një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;

ii) të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;

iii) familjet me më shumë se katër fëmijë;

iv) familje të reja;

v) të rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç.

c) Kushtet sociale, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi:

i) personat me aftësi të kufizuara, sipas pikës 28 të nenit 2 të këtij ligji;

ii) individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore dhe deri në moshën 30 vjeç;

iii) familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave ish-pronarëve;

- iv) emigrantët e rikthyer, punëtorët emigrantë dhe azilkërkuesit refugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese, në kuptim të legjislacionit përkatës;
 - v) familjet e policëve të rënë në detyrë;
 - vi) punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë (FNSH);
 - vii) punonjësit e repartit RENEA; viii) punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;
 - ix) shfuqizuar;
 - x) viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit;
 - xi) anëtarët e komunitetit rom;
 - xii) anëtarë të komunitetit egjiptian;
 - xiii) të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pas ekzekutimit të dënimit;
 - xiv) vajzat nëna;
 - xv) individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktimat për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi që përcakton se si pasojë e diskriminimit individi nuk ka një strehim të përshtatshëm dhe që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të këtij ligji.
- ç) Kushtet ekonomike, në bazë të të cilave përcaktohen familjet, sipas grupeve të të ardhurave, të përcaktuara në këtë ligj”.

Ligji Nr. 22/2018, “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, në Kreun VI “Programi për përshtatjen e përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave”, parashikohen objektet dhe banesat, që trajtohen nga programi i përmirësimit të kushteve ose i përmirësimit të kushteve deri në ndërtim të ri, mënyra e zbatimit dhe përfituesit.

Sakaq, në **Nenin 40 “Kuptimi dhe qëllimi”**, parashikohet se: “1. Programi për përshtatjen e objekteve, pronë shtetërore, nënkupton ndihmën që u jepet, me grante konkurruese, njësisive të vetëqeverisjes vendore nga buxheti i shtetit, për t’i kthyer ato në banesa, me qëllim strehimin. Procesi i kthimit të këtyre objekteve në fond banese miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Objektet e kthyer në fond banese sipas këtij neni qëndrojnë në pronësi të njësisive të vetëqeverisjes vendore dhe përdoren për programin e banesave sociale sipas shkronjës “c” të pikës 2 të nenit 17 të këtij ligji.

2. Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese private ose pronë shtetërore nënkupton ndihmën që u jepet, me grante konkurruese, njësisive të vetëqeverisjes vendore nga buxheti i shtetit për këtë qëllim.

3. shfuqizuar”.

Neni 41 “Objektet/banesat që trajtohen nga programi i përmirësimit të kushteve”, përcakton se:

“ 1. Objektet dhe banesat, që trajtohen nga programi i përmirësimit të kushteve, janë:

a) objektet/banesat në rrezik shembjeje;

b) objektet/banesat e amortizuara, që kanë nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime të domosdoshme.

2. Administrimi i kërkesave dhe identifikimi i ndërhyrjeve për përmirësimin e kushteve të

objekteve/banesave ekzistuese duhet të bëhet nga struktura përkatëse e njësisë së vetëqeverisjes vendore”.

Neni 42 “Instrumentet e programit të kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, parashikon se: “1. Programi për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese realizohet nëpërmjet grantit konkurrues për:

- a) përmirësimin e zonave të papërshtatshme sipas përcaktimit në pikën 52 të nenit 2 të këtij ligji;
- b) përshtatjen e objekteve shtetërore të dala jashtë funksionit, me kusht që kostoja për metër katror për realizimin e investimit për njësinë e vetëqeverisjes vendore ku realizohet investimi të mos jetë më e lartë se 80% e koston së ndërtimit, të miratuar sipas shkronjës “dh” të nenit 72 të këtij ligji;
- c) përmirësimin e banesave të amortizuara dhe atyre në rrezik shembjeje, me kushtin që kostot e përmirësimit të mos jenë më të larta se 70% e koston së ndërtimit të një objekti të ri, sipas normave të strehimit.

2. Kriteret dhe procedurat e përfitimit dhe dhënies së granteve konkurruese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Kufijtë e financimit për çdo projekt individual dhe masa e granteve për çdo familje përcaktohen në termat e referencës, që miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për strehimin çdo vit para shpalljes së garës për grantin konkurrues.”.

Neni 43 “Përfituesit nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit”, përcakton se:

“1. Nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit, si dhe përmirësimit deri në ndërtim të ri përfitojnë familjet/individët, të cilëve u mungon një strehim i përshtatshëm.

2. Përparësi në trajtimin me këtë program kanë:

- a) personat me aftësi të kufizuara;
- b) individët me statusin e jetimit;
- c) familjet e policëve të rënë në detyrë;
- ç) të moshuarit;
- d) komuniteti rom;
- dh) komuniteti egjiptian;
- e) komunitetet e zonave rurale;
- ë) prindërit e vetëm;
- f) viktima të trafikimit /viktima të mundshme të trafikimit;
- g) viktima të dhunës në familje”.

Në analizë të legjislacionit të sipërcituar, evidentohet fakti se njësitë e vetëqeverisjes vendore, kanë kompetenca në ndërtimin dhe administrimin e banesave të strehimit social, si dhe në dhënien e subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë. Një prej programeve të strehimit social është edhe ai për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri dhe zonave të papërshtatshme, për të cilin ka aplikuar edhe ankuesi.

Referuar kritereve të përcaktuara më lart, ankuesi si person me aftësi të kufizuara mund të jetë përfitues i programit për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri. Por, për të qenë përfitues i këtij programi subjekti ankues, duhet që:

- *së pari, të plotësoj kushtet që banesa e tij të jetë në rrezik shembjeje ose e amortizuar, që ka nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime të domosdoshme;*
- *së dyti, njësia e vetëqeverisjes vendore të disponoj program për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese private që nënkupton ndihmën që u jepet, me grante konkurruese, njësive të vetëqeverisjes vendore nga buxheti i shtetit për këtë qëllim.*

Referuar në informacionin e administruar në Programin 5- Vjeçar të Strehimit Social 2023-2028, Plani Lokal i Strehimit Social, të Bashkisë Lushnje⁸, evidentohet se, nga viti 2020 e në vijim, Bashkia Lushnje vit pas viti ka përgatitur dokumentacionin dhe dorëzuar kërkesën pranë Entit Kombëtar të Banësive për financimin me grante për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese private, por nuk ka përfituar. Programi i vetëm që aplikohet në Bashkinë e Lushnjes është subvencionimi i qirasë në treg të lirë, ose ndryshe bonusi i qirasë. Nga informacioni i administruar rezulton se kërkues për përfitimin nga programi i përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese private në Bashkinë Lushnje për vitin 2020, kanë aplikuar 50 familje; për vitin 2021, 72 familje dhe për vitin 2022, kanë aplikuar 95 familje. Asnjë prej tyre nuk ka qenë përfitues i këtij programi në Bashkinë Lushnje duke qenë se nuk ka përfituar financime nga ana e buxhetit të shtetit.

Në analizë të informacionit dhe legjislacionit të sipërcituar, konstatohet se Bashkia Lushnje nuk ka ofruar dhe nuk ka patur financime për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese private të paktën për 5 vitet e fundit. Gjithashtu evidentohet se jo vetëm ankuesi, por edhe të gjitha familjet e tjera të cilat kanë aplikuar për të përfituar nga programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese private, nuk kanë qenë përfitues. Pavarësisht kësaj, referuar përgjigjes së Bashkisë Lushnje, drejtuar ankuesit, evidentohet se edhe pse T. B. nuk ka qenë përfitues i programit të përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese private, i është ofruar të aplikojë për të qenë përfitues nga programi i subvencionimit të qirasë nga ana e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Bazuar në tërësinë e arsytimit të mësipërm, si dhe në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se, T. B., nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e Bashkisë Lushnje. Në mungesë të trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nga ana e subjektit kundër të cilit pala ankuese ka paraqitur ankesën, Bashkia Lushnje.

PËR KËTO ARSYE :

⁸ <https://bashkialushnje.gov.al/strehimi/>, faqja 16.

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të T. B., në fushën e të mirave dhe shërbimeve, për shkaqet e pretenduara prej tij, nga ana e Bashkisë Lushnje.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Orientimi seksual, gjendja ekonomike dhe aftësia e kufizuar)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)